

**URDHËR**  
**Nr.302, datë 8.5.2020**

**“PËR NJË SHITESË DHE NDRYSHIM NË URDHRIN NR. 193, DATË 20.3.2020**  
**“PËR MBYLLJEN APO KUFIZIMIN E LËVIZJEVE NË REPUBLIKËN E**  
**SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të neneve 7, pika 4, dhe 15, të ligjit nr.15/2016,“ Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, të ndryshuar, si edhe në zbatim të udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga COVID-19,

**URDHËROJ:**

Në urdhrin nr.193, datë 20.3.2020 “Për kufizimin e lëvizjeve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Fjalja e fundit e pikës 3, ndryshohet si më poshtë:

“Përfundim nga ky rregull bëhet për pikat e shitjes së produkteve ushqimore me pakicë dhe farmacitë, të cilat ditën e shtunë, datë 9 maj 2020, lejohen të ushtrjnë aktivitetin e tyre deri në orën 17:30.”

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE**  
**Ogerta Manastirliu**